

Data: 23 /04/ 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Rehabilitimi i hapësirës së pallateve në kryqëzimin e rrugës “Kujtim Laro” dhe “Kongresi i Manastirit”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi.

Vlera e fondit limit: 9,046,061.66 (nëntë milion e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 4 (katër) muaj.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; (i ndryshuar) Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare (2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

2. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **3,618,424** (tre milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

1. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **2,713,818** (dy milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **9,046,061.66** (nëntë milion e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatëse.
- 1.3 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 2,713,818 (dy milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **9,046,061.66** (nëntë milion e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme. *Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më

shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: ***“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”***

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jene të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër

të tjera përcaktohet se: *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

2. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime gërmimi në tokë.
- NP-4 A Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
- NP-7 A Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- NP-11A Ndërtime për nënstationet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NS-6 A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS-18 A Punime topogjeodezike

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
---------------------	--	--	---

NP-1 A	Punime germimi ne toke	<p style="text-align: center;"><i>Emërtimi i Punimeve</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet • Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet • Germime dheu ne seksion te lire me krahe,ne toke te bute,kateg.I-II, trans.karro dore deri 10 m • Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m² • Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke 	<p>0,21 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventivin e punimeve</p> <p>307,403.83</p>
NP-4 A	Rrugë , autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	<ul style="list-style-type: none"> • Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri • Ndertim kasonete ne toke mesatare • Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri • Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri • Shtrese stabilizant t=10cm • Shtrese çakelli t=25cm, me cilindrim • Nenshtrese rere • Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri • Struktura monolite betoni C 16/20 • Struktura monolite betoni C 20/25 • F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm • Shtrese betoni C 12/15 • Prishje trotuari ekzistues • F.V. Pllaka betoni t=6cm per trotuare 	<p>0-20 milion leke</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>5,275,175.4</p>
NP-7 A	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.	<ul style="list-style-type: none"> • Ndertim puseta betoni H=2.5-3m, D=1m + kapak gize • F.V. Tuba metalik D=140mm • Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 200 cm • Puse kontrolli 1x1x1.5m • FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, Pn 16 • Pusete shiu 40x60cm, H= 100-150cm, me kapak kompozit • F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm • F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200mm • F.V hidrant Ø 80 mm mbitokesor + rakorderi 	<p>0-20 milion leke</p> <p>Vlera e parashikuar e punimeve</p> <p>1,248,249.09</p>
NP-11 A	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	<ul style="list-style-type: none"> • Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret) • F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm • F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement • FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 • FV elektroda tokezimi te xinguar 50x3mm L=150cm • F.V. Shtylle ndricimi H=3.8ml me ndricuesLed 60W (perfshire gjithe aksesoret enevojshem: morseteri, ndricues,etj) • F.V. Tub fleksibel PVC I korruguar, djegie pa flake, dhe emetim gazi; tipi I rende, Ø 63 mm, me te gjithe aksesoret (tub, mbushja me rere, tulla, shtresa e 	<p>0-20 milion leke</p> <p>Vlera e parashikuar e punimeve</p> <p>903,418.18</p>

		sinjalizimit) <ul style="list-style-type: none"> • F.V. Tub metalik Ø 110 mm • Pusete kontrolli betoni per linjat rezerve, telefonine dhe fibren optike 40x40x60cm me kapak metalik • F.V. Tub fleksibel PVC I korruguar, djegie pa flake, dhe emetim gazi; tipi I rende, Ø 110 mm, me te gjithë aksesoret (tub, mbushja me rere, tulla, shtresa e sinjalizimit) • F.V. kabell FG7OR 0.6/1KV 5x6 mm2 • F.V. Kabell bakri Cu 1x25mm2 • Kasete shperndarese • Mates energjie 	
NS-6 A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	<ul style="list-style-type: none"> • Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Bikomponente (paste) • Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikomponente (sprajt) • FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm • F.v. Tabele katrore normal me A=60 • F.v. Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30 • 	0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 244,996.1

N.P-1A (Punime gërmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndertimin e infrastruktures, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorine N.P-4 D ku bëjnë pjesë në kategorinë rrugë.

N.P-7A Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per Ujesjiellës, kanalizime, sistem vaditje etj, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine N.P-7A , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-11 A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per ndricimin, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine NP-11A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-6A (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese)

Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune qe kane te bejne me sinjalistika ne rruge, te cilat shtrojne te nevojeshme qe Operatori Ekonomik te jete i licensuar per kategorine N.S-6A.

NS-18 A. Punime topogjeodezike

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndertimin e infrastruktures dhe një parkimi nëntokësorë, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorine N.S 18 A ku është pjesë e rëndësishme punimet topografike.

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

4. Një punësim mesatar i të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar si dhe listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori

ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 15 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 4 muajve, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi;

1 (një) inxhinier Hidroteknike;

1 (një) inxhinier Elektrik;

1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2,

kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar N.P –1, N.P –4, N.S – 6, eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Ndërtimit dhe arkitektit.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar NP-7, eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit Hidroteknik.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar NP-11, eshte e nevojshme prezenca e Inxhinierit Elektrik.

Referuar preventivit te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar NS-18, eshte e nevojshme prezenca e Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

6. Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrefikës ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “*Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin*“, ku citohet se: “*Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kritereve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit*”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkakimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikës ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin.

7. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:
 - a) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë

individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")*.

- b) 1 (nje) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë")*.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë* si dhe për *Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010, "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*", sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

Punonjes Staf Teknik

- 1 (një) teknik ndertimi;
- 1 (një) punonjes hidraulik
- 1 (një) punonjes elektriciste

Punonjes Manovrator (shofer)

- 1 (nje) Punonjes eskavatoriste
- 1 (një) punonjes automakinist

8.1 Për stafin teknik ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale e punës;
- b) Per tekniket e ndertimit dhe mekanik diplomën perkatëse, ndersa per punonjesit e tjere diplome/certifikate që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm leshuar nga institucionet e akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore ne Republiken e Shqiperise;
- c) Deshmi Kualifikimi te sigurimit teknik e vlefshme, e cila duhet te jete e lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve;
- d) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i kualifikimit per diplomën/certifikaten përkatëse, si dhe institucionin qe ka leshuar kete dokument.

8.2 Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*
- c) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit eskavatoriste dhe automakinist, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr.15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Ne lidhje me 1 (nje) Teknik ndertimi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (nje) punonjes hidraulike prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (nje) punonjes elektrikist prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (nje) eskavatorist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (nje) automakinist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 4 (katër) muaj.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3 dhe kanë të bëjnë me grafikun e punimeve; fazat si dhe afatet e realizimit të punimeve.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015)
- b) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 14001-2015.
- c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 45001-2018.
- d) Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 39001-2012.
- e) Çertifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara

nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). Njësia e Prokurimit gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (ndërtim rruge) ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 39001:2012.

ISO 50001-2018 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2018. Në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”. Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 12 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

11. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Autovinç	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Vinç kulle deri ne 5 Ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Makineri skarifikim shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autobitumatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Rul me Vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Betonjere 500l	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator thellesie	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Vibrator sipërfaqësor	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Eskavator 0.25m ³ me gome	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Autobetoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Elektrosaldatriçe	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Rul me vibrim	copë	1	Në pronësi ose me qera

17	Gazogjen	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Rul me kompresor	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 -10Ton	copë	1	Në pronësi ose me qera

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.
- g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe

teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fitesit do t'i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s'kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s'kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.